

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. Xh. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.833-1/2016 të datës 17.05.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Beqë Shala dhe të akuzuarit, me datë 18.04.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**M. XH.** nga i ati M. dhe e ëma F. e lindur B., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton rruga... pa nr., ka të kryer shkollën e mesme, zjarrfikës – tani në pension, i martuar, baba i dy fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

**ËSHTË FAJTOR**

Me datë 14.01.2016, në Prizren rrugën... në shtëpinë e tij familjare, me qëllim që ti sjell vetit pasuri të kundërligjshme si shfrytëzues i shërbimeve komunale, përfiton nga shërbimi komunal që furnizohet përmes rrjetit përcues dhe shpërndarjes së energjisë elektrike pa autorizim të furnizuesit të autorizuar e shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë të drejtpërdrejtë jashtë njehsorit elektrik ku faza L2 hyrja është në dalje – janë të përbashkëta, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS – Distribucioni në Prizren ka shkaktuar dëm material.

**Kësodore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.**

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 320 të KPK i shqipton dënimin dhe atë:

**DËNIM ME KUSHT**

Ashtu që vërteton

- dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

- dënimin me gjobë në lartësi prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I akuzatri obligohet në emër të dëmit të shkaktuar të dëmtuarës KEDS – Distribucioni në Prizren, të paguaj shumën në lartësi prej 99.93 €, pesëmbëdhjetë ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, pasi që i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike – është pensioner, prandaj lirohet nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore sepse pagesa e tyre do të rrezikon gjendjen material të akzuarit.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.833-1/2016 të datës 17.05.2016, kundër të akzuarit M. Xh. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në seancën fillestare ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 14.01.2016, në shtëpinë e tij familjare e cila gjendet në Prizren rrugën..., i akuzuari M. Xh. me shifër të konsumatorit 9035222 me numër të njehsorit elektrik 63799597, pas një kontrolli nga ana e zyrtarëve të KEDS – Distribucioni në Prizren, është vërtetuar se i akuzuari përfiton nga shërbimi komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues dhe shpërndarjes së energjisë elektrike pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, e shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë të drejtpërdrejtë jashtë njehsorit elektrik ku faza L2 hyrja është në dalje – janë të përbashkëta, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS – Distribucioni në Prizren ka shkaktuar dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akzuarit për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ekzistuar ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza, me ç'rast i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, është i gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës i familjes, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i

dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi kompensimin e dëmit të dëmtuarës, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1015/2016 të datës 18.04.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimet, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.